4777

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 4777 Vendimi 200 Leke

# V E N D I M

## MBI RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 3.6.1993, une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane, Marjana Dedi, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga Genc Gambeta per rregjistrimin e personit juridik dhe :

## K O N S T A T O V A

Se, kerkuesi Genc Gambeta ka paraqitur kerkesen per rregjistrimin e personit juridik per te ushtruar veprimtari private ne fushen e projektimin dhe zbatimin e kategorive te meposhteme: Kati pare, punime dheu, muratura, betoni, betonarme, punime shembjesh; Kati dyte, ndertime civile, industriale, turistike, buqesore e te tjera si dhe kompletim me istalimet nevojshme per to; Kati trete, punime restaurimi; Kati katert, vepra betonarm te veçanta, importin dhe eksportin e materialeve ti ndirtimit dhe tè mallrave te ndryshme industriale. Ky aktivitet do te ushtrohet ne shoqerine private "MELD".

Kerkesa e bere eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj e si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te nenit 5 te ligjit Nr.7512 date 10.8.1991

## V E N D O S A

Rregjistrimin e kerkuesit Genc Gambeta si person juridik per te ushtruar veprimtari private ne fushen e projektimit dhe zbatimit te kategorive te meposhteme: Kati Pare-punime dheu, murature, betoni, betonarme, punime shembjesh. Kati dyte-ndertime civile, industriale, turistike, buqesore e te tjera e kompletime e istalimet e nevojshme per to. Kati trete-punime restaurimi. Kati katert-vepra betonarme te veçanta, importim dhe eksportin te materialeve te ndertimit dhe mallrave te ndryshme industriale, shoqi[...] "MELD".

Kunder vendimit lejohet ankim.

G J Y Q T A R E

Marjana Dedi

Tirane, me 3.6.1993

4777

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR.____________VENDIMI

V E N D I M
I
GJYQTARIT TE VETEM

Sot, me date 20.10.1997, para meje Gjyqtares se Gjykates se rrethit Tirane u paraqiten kerkesa dhe dokumentacioni i shoqerise "M E L D" sh.p.k. i cili kerkon depozitimin e dokumentave prane Zyres se regjistrit tregtar te Gjykates se rrethit Tirane.
Pas shqyrtimit te kerkeses dhe dokumentave:

K O N S T A T O V A

Se me vendim te Gjykates se rrethit Tirane,nr.4777 date 02.06.1993 eshte regjistruar si person juridik shoqeria "M E L D" SH.P.K.
Me vendim te Ortakut te Vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur shtimi i objektit te aktivitetit te kesaj shoqerie si edhe ndryshime ne aktin e themelimit dhe te Statutit per sa i perket bazueshmerise ne ligjin 7667 " Per shoqerite tregtare"
Pas shqyrtimit te kerkeses dhe dokumentacionit te paraqitur,rezultoi se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet pranuar.

P E R K E T O A R E S Y E

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe 7638 dt.19.11.1992.

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses se mesiperme.
Depozitimin e ne regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane, te vendimit te Ortakut te Vetem te shoqerise "M E L D" SH.P.K., .
Urdherimin e Zyres se regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese, ndarjen me vize te kuqe te ndryshimeve te bera.
Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykaten e Apelit Tirane.

Tirane, me 20.10. 1997

G J Y Q T A R E

Ferila Capo

# S T A T U T I

## I SHOQATËS PRIVATE TË NDËRTIMIT
"MELD"

Statuti u hartua sot dt.20.5.1993 në Tiranë nga presidenti i Shoqërisë "Meld", ing Genc Gambeta. Në bazë të ligjit Nr.7512 dt.10.8.91 hartohet ky Statut i Shoqërisë Private "Meld" për zhvillimin e aktivitetit të saj.

Neni 1

Shoqëria "Meld" me president ing. Genc Gambeta do të zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë Shqipërinë. Selia kryesore e Shoqërisë do të jetë në Tiranë në këtë adresë Genc Gambeta. Rruga "Ismail Qemali",Nr.29 Tiranë.

Neni 2

Kjo Shoqëri do të ketë si objekt kryesor aktivitetet si më poshtë:
- Projektimin dhe zbatimin e kategorive të mëposhtme:
  Kat 1 - punime dheu,muraturë,betoni,b/arme,punime shëmbjesh.
  Kat 2 - ndërtime civile,industriale,turistike,bujqësore etj e kompletimin me instalimet e nevojshme për to.
  Kat 3 - punime restaurimi.
  Kat 4 - vepra b/arme të veçanta.
- Importin dhe eksportin e materialeve të ndërtimit dhe të mallrave të ndryshme industriale.

Neni 3

Shoqëria do të ketë një kapital fillestar prej 10 mijë lekë e derdhur në një llogari rrjedhëse pranë bankës së Shtetit Shqiptar dhe të një makine tip kamionçinë me vleftë rreth 300 mijë lekë.

Neni 4

Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj duke përdorur kapitalet e veta. Përdorimi i tyre do të bëhet kur Shoqëria është e detyruar të ndreqi të metat e shkaktuara për faj të saj të cilat nuk ka patur mundësi të vihen re gjatë dorzimit të objektit Shoqëria do të hapi lloga rrjedhëse dhe në një nga bankat e huaja në përputhje me ligjet e Shtetit Shqiptar.

Neni 5

Dhënia e pagës punonjësve do të bëhet sipas kushteve të parashiku në kontratën e punës që do të lidhet midis Shoqërisë dhe punonjësve në konfromitet me dispozitat ligjore në fuqi,fondi rezervë do të krijohet nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë mbasi të jenë zbritur të gjitha shpenzimet dhe fitimi i zakonshëm për çdo vit.

Neni 6

Lejohet që Shoqëria të lidh kontrata dhe marëveshje të veçanta

ose të krijojë ndërmarrje të përbashkëta në përputhje me dispozitat ligjore dhe në ligjore në fuqi, me shoqëri të huaja duke ju përmbajtur aktivitetit kryesor të saj. Për këtë do të përgatitet dhe firmoset dokumentacioni përkatës.

N
eni 7

Për ushtrimin e aktivitetit të saj Shoqëra do të marrë në shërbim inxhinjerë specialistë,puntorë dhe personel administrativ në përputhje me ligjet në fuqi dhe me kontrata të rregullta.

Neni 8

Presidenti i Shoqërisë në kryerjen e aktivitetit të saj do të ketë si ndihmes Këshillin Konsultativ ku do të shtrohen dhe diskutohen problemet më kryesore të punës.

Neni 9

Shoqëria "MELD" është pronë e ing. Genc Gambeta dhe veprimtaria e saj do të bazohet në Statutin dhe Rregulloren të hartuar konform dispozitave ligjore. Mosmarveshjet që mund të lindin me klientët ose organet e tjera do të zgjidhen kryesisht me mirëkuptim dhe në raste të veçanta me anën e gjykatave.

Neni 10

Dispozita të hollësishme paraqiten në Rregulloren e Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Statuti.

Neni 11

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë mbas regjistrimit të Shoqërisë në Gjykatën e Rrethit.

President i Shoqërisë "MELD"
ing. GENC GAMBETA

# KËRKESË

Gjykatës së Rrethit Tiranë

Unë i nënshkruari Genci Stavri Gambeta lindur në 24.5.1955 në Tiranë, me profesionin inxhinier ndërtimi, diplomuar në 1879 banues në Tiranë, rruga "Ismail Qemali", Pallati 26/6, kërkoj pranë Gjykatës së Rrethit Tiranës të miratojë kërkesën time për krijimin e Shoqërisë Private "Meld". Kjo shoqëri do të ketë si objekt kryesor aktivitetet si më poshtë:

- Projektimin dhe zbatimin e kategorive të mëposhtme:
  - Kat 1 - punime dheu,murature,betoni,b/arme punime shëmbjesh.
  - Kat 2 - ndërtime civile,industriale turistike,bujqësore etj, e kompletim me instalimet e nevojshme për to.
  - Kat 3 - punime restaurimi.
  - Kat 4 - vepra b/arme të veçanta.
- Importin dhe eksportin e materialeve të ndërtimit dhe të mallrave të ndryshme industriale.

Shosëria do të zhvillojë aktivitet kryesisht në Tiranë por dhe në rrethe të tjera të vëndit.

Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e saj.

Selia e Shoqërisë do të jetë Rruga "Ismail Qemali", Nr.29 Tiranë.

Ju lutem të merni parasysh kërkesën time për miratimin e Shoqërisë "Meld".

Tiranë 20.5.1993

GENC GAMBETA

Të regjistrohet
dt 3-6-93

3

PULLE TAKSE 50 LEKE R.SHQIPERISE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**SHOQERIA " M E L D" SH.P.K.**
**SELIA, QYTETI TIRANE**

## V E N D I M

## I
## ORTAKEUT TE VETEM

Sot, me date 20 Tetor 1997 (nentedhjete e shtate) ne seline e shoqerise "M E L D", Ortaku i vetem i kesaj shoqerie zhvilloi mbledhjen e tij te radhes ne lidhje me shtesen e objektit te aktivitetit te kesaj shoqerie dhe per disa ndryshime ne Aktin e themelimit dhe ne Statut per sa i perket bazueshmerise ne ligjin nr.7667 per "Shoqerite Tregtare".

Pas diskutimeve te bera ne kete mbledhje te Ortakut te vetem u vendos qe ne objektin e aktivitetit te kesaj shoqerie pervec aktivitetit te meparshem kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetit e saj ne fushen e Spedicionit , agjensi e veprimeve spedicionere, transport te mallarave dhe te udhetareve, agjensi e udhetimeve, shitje biletash dhe aksesore te tjere te kesaj fushe, agjensi doganore dhe agjensi e sherbimeve detare.

Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, te industrise se lehte dhe ushqimore, lendde te pare per to, elektroshtepiake, konfeksione, importin dhe eksportin e tyre.

Po keshtu ne kete mbledhje u vendos qe t'i behen disa ndryshime aktit te themelimit dhe Statutit te kesaj shoqerie ne lidhje me bazueshmerine ne ligjin 7667 per "Shoqerite Tregtare".

-Kryerjen e te gjitha veprimeve te nevojshme per depozitimin e dokumentacionit te nevojshem per kete qellim.

**ORTAKU I VETEM**

**GENCI GAMBETA**
Genci Gambeta

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTERISE**
**T I R A N E** **NR.** 8729 **REP.NR.** 1240 **KOL.**

## V E R T E T I M

Sot, me date 20 Tetor 1997, para meje Noteres se rrethit Tirane u paraqiten personalisht GENCI GAMBETA , madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili bie dakort se sa me siper eshte sipas vullnetit te tij te lire e te plote dhe e nenshkroi para meje dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.

**N O T E R E**

Shpresa Kurti

Dep. nr. 4473
Dt: 27/10/1997

4777

DHOMA E AVOKATEVE
T I R A N E

**K E R K E S E**

KERKUESI: GENCI GAMBETA, banues ne Tirane, rr. "I.Qemali"nr.29 , si Ortak i vetem i shoqerise " M E L D" sh.p.k.

OBJEKTI: Depozitimin e dokumentacionit si vendim ortakut të vetëm ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 si edhe te ligjit 7638 dt 19.11.1992.

---

PER KOMPETENCE

GJYKATES SE RRETHIT

T I R A N E

Me vendim te gjykates se rrethit Tirane nr. 4777 dt.02.06.1993, ne Gjykaten e rrethit Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria " M E L D" sh.p.k..

Me vendim te Ortakut te Vetem te kesaj shoqerie eshte vendosur te behen shtese ne objektin e aktivitetit te kesaj shoqerie ku pervec aktivitetit te parashikuar ne vendimin e regjistrimit te kesaj gjykate , kjo shoqeri te ushtroje aktivitetin e saj edhe ne fushen : - Spedicionit, agjensi e veprime spedicionere, transport te mallrave dhe te udhetareve, agjensi e udhetimeve, transport te udhetareve, shitje biletash dhe aksesore te tjere te kesaj fushe, agjensi doganore, agjensi e sherbimeve detare.

- Tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, konfeksione, te industrise se lehte dhe ushqimore, lende te pare per to, elektroshtepiake, importin dhe eksportin e tyre.

Po keshtu ne kete vendim eshte vendosur edhe per disa ndryshime ne prgjithesi te dy dokumenteve baze, te Aktit te themelimt dhe statutit te kesaj shoqerie.

Meqenese ndryshimet perkatese duhet te depozitohen prane Gjykates se rrethit Tirane, po ju drejtohem juve qe pasi te shqyrtoni kerkesen te vendosni sipas objektit.

Bashkalidhur po ju paraqesim edhe dokumentat shkresore.

K E R K U E S I

GENCI GAMBETA NF 491414

Genci Gambeta

Depozituar 20.10.97

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 8732 rep.

V E R T E T I M

Sot, me date 20.10.1997, para meje Noteres se rrethit Tirane u paraqit personalisht GENCI GAMBETA, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar i cili deklaroi se sa me siper eshte sipas vullnetit te tyre te lire e te plote dhe e nenshkroi para meje rregullisht dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.

PULLE-TAKSE
50 LEKE
R.SHQIPERISE

N O T E R E

Shpresë Kurti

MINISTRIA E NDERTIMIT ,STREHIMIT N.0245

E RREGULLIMIT TE TERITORIT

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE

## L I C E N S E

Ndermarrja private me emertimin "MELD"

me adrese Tirane

me drejtues teknik z.Genc Gambeta.

me perfaqesues ligjor z.Genc Gambeta.

eshte regjistruar ne regjistrin themeltar te ndermarrjeve per projektim dhe zbatim nga data 26.4.1993 per kategorite e specifikuara te punimeve:

Kat1 - punime dheu,murature,betoni,b/arme te zakonshme, punime shembjesh.

Kat2 - ndertime civile,industriale,turistike, bujqesore etj. e kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat3 - punime restaurimi.

Kat4 - vepra b/arme te vecanta.

Sekretare e Komisionit

Elsa Jucja

Kryetari i Komisionit

Arben Demiri

Pulla e Takses

n. 728

Data 4. 5. 1993

4

MINISTRIA E NDERTIMIT ,STREHIMIT K. 0220

E RREGULLIMIT TE TERITORIT

KOMISIONI I DHENIES SE LICENSAVE PROFESIONALE

L I C E N S E

Z. Genci Stavri Gambeta,lindur me 24.5.1955,ne Tirane me profesion inxhinier ndertimi ,diplomuar ne vitin 1979 ne Fakultetin e Inxhinierise Ndertimit,dega Ndertim, banues Tirane,rruga "Ismail Qemali",pallati 26,ap.6.

Ne baze te kerkeses dhe te dhenave disponuese i jepet license per projektim dhe zbatim dhe regjistrohet ne regjistrin themeltar te konstruktorit qe nga data 26.4.1993,per kategorite e specifikuara te punimeve :

Kat1 - punime dheu,murature,betoni,b/arme te zakonshme, punime shembjesh.

kat2 - ndertime civile,industriale,turistike,bujqesore etj,e kompletimi me instalimet e nevojshme per to.

Kat3 - punime restaurimi.

Kat4 - vepra b/arme te vecanta.

Sekretare e Komisionit

Elsa Jucja

Kryetari i Komisionit

Arben Demiri

Pulla e Takses
Flc. 726

data 4.5.1993

5